



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 31
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 19 dhjetor 2018, në orën 13:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Drita Millaku, Haxhi Avdyli, Time Kadrijaj, Naser Rugova, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, dhe Fikrim Damka.

Munguan: Miljana Nikoliq dhe Fatmire Mulhaxha-Kollçaku.

I ftuar: Blerim Syla, kryetar i FSSHK-së.

Pjesëmarrës tjerë: Selman Selmani - FSSHK, Kole Krasniqi- FSSHK dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.11.2018;**
3. **Takim me Federatën e Sindikatës së Shëndetësisë së Kosovës;**
4. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të mbajtur më 21.11.2018;**

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më datë 21.11.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Takim me Federatën e Sindikatës së Shëndetësisë së Kosovës;

Besa Baftiu, kryetare, tha se ne si Komision me FSSHK-në jemi në vazhdimësi në kontakte të rregullta, përmes pjesëmarrjes nëpër takime, tryeza konferenca. Kemi shqyrtuar bashkërisht në kuadër konferencës që është organizuar në lidhje me Ligjin e pagave, me theks të veçantë sektorin e shëndetësisë. Me kërkesë të tyre, ne i kemi ftuar që sot bashkërisht të diskutojmë për situatën aktuale në sektorin e shëndetësisë, me theks të veçantë projektligjin për paga. Si komision, i kemi shqyrtuar kërkesat edhe të FSSHK-së, kërkesat e odave tjera të profesionistëve shëndetësorë, të cilat na kanë dërguar dhe pas shqyrtimit të kërkesave, ne si komision kemi bërë disa propozime amendamente, të cilat i kemi proceduar si Komisioni funksional.

Blerim Sylja, kryetar i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, tha se, në këtë rast, si përfaqësues të profesionistëve shëndetësorë në Kosovë, kemi pasur çdoherë bashkëpunim të mirë me Komisionin parlamentar. Ju falënderoj për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave tona si dhe odave dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë, si komision i kemi shqyrtuar dhe kemi bërë amendamente për të përmirësuar statusin e profesionistëve shëndetësorë në ligjin për paga. Urojmë që Ligji i pagave të miratohet dhe profesionistët shëndetësorë të kenë paga të dinjitetshme për punën e tyre që e bëjnë.

Si FSSHK kemi punuar shumë, kemi shqyrtuar Projektligjin për paga dhe kemi dhënë rekomandimet tona duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet si dhe ju kemi paraqitur kërkesat tona edhe të gjitha partive politike në lidhje me Projektligjin për paga. Tash projektligji ka ardhur në Kuvend dhe ne e kemi parë se në Projektligjin për buxhetin 2019, nuk është paraparë rritja e pagave. Me këtë rast, kemi parashtruar kërkesë për takim me tri komisionet, me Komisionin për Shëndetësi, Komisionin për Buxhet dhe Komisionin për Administratë Publike, për ti parashtruar drejtpërdrejt kërkesat dhe shqetësimet tona. Shqetësim për ne ka qenë edhe informacioni se edhe nëse miratohet ligji, zbatimi i tij do të ndodhë në vitin 2020, sipas Ministrisë së Financave kjo ka qenë shumë shqetësuese edhe e papranueshme për ne si FSSHK.

Ne sot s'kemi çka të shtojmë lidhur me kërkesat tona ato me tash janë të njoftuara për ju. Situata nuk është aspak e mirë në sektorin e shëndetësisë ju siç e dini ne kemi organizuar greve para miratimit të projektligjit për paga me qellim që të kemi trajtim të dinjitetshëm në ligjin e pagave. E lusim Kryeministrin, Kryeparlamentarin, ju si komision dhe të gjitha institucionet relevante, tash e kemi rastin që përmes Ligjit për paga, ta rregulloni këtë çështje. Nesër e kemi takimin me Këshillin Drejtues, ku e kemi ftuar edhe Kryeministrin dhe ministrin e shëndetësisë, që të adresojnë këtë çështje. Përveç grevës 24 orësh që ka filluar në QKUK dhe ka përfunduar me sukses, kemi frikë se do të marrim veprime më radikale, të cilat nuk i dëshirojmë. Nëse nuk ka veprime konkrete për rritje të pagave, pra nuk përfshihet në buxhetin e vitit 2019, në janar situata do të përshkallëzohet përmes veprimeve sindikale.

Besa Baftiu, tha se edhe ne jemi dëshmitarë të kësaj situatë. Janë dhënë premtime se prej janarit të vitit 2019, do të këtë rritje të pagave për punëtorët shëndetësorë. Edhe ne si deputetë kemi presion përmes kërkesave, pyetjeve pse nuk po e miratoni me shpejt Ligjin për paga pasi që të gjithë kanë pritje se do të kenë rritje të pagave. Ne si komision e kemi bërë punën tonë, i kemi dërguar amendamentet në Komisionin funksional dhe do t'i mbrojmë këto amendamente para Komisionit funksional dhe në seance gjatë miratimit të projektligjit.

Sa i përket deklaratimit tuaj për radikalizmi të veprimeve, në këtë rast, duhet të kemi parasysh se janë pacientët që me së shumti dëmtohen me mosmarrje të shërbimeve mjekësore, prandaj ne duhet të gjejmë një zgjidhje dhe Qeveria duhet të këtë parasysh edhe anën e punëtorëve shëndetësorë dhe anën e pacientëve.

Haxhi Avdyli, tha se puna e FSSHK-së në ngritjen e zërit në mbrojtjen e punëtorëve shëndetësorë ka qenë evidente dhe ju keni punuar në vazhdimësi që të trajtohen punëtorët shëndetësorë në mënyrë të dinjitetshme edhe përmes pagës së dinjitetshme. Ligji për kategorizimin e pagave sipas informatave që kemi nga Ministria e Financave, nuk ka gjasë që të vijë në fillim të vitit të ardhshëm dhe kjo ka shkaktuar një zhgënjim shumë të madh të punëtorëve shëndetësorë, pasi që prishmëria e tyre ka qenë se në vitin e ardhshëm do të kenë rritje të pagave. Sipas planifikimeve të MF-së, hyrja në fuqi apo aplikimi i rritjes së pagave do të ndodhë me rastin e rishikimit të buxhetit në mes vitit 2019, apo më real është viti 2020. Ne si komision parlamentar për shëndetësi mbështesim kërkesat e profesionistëve shëndetësorë, prandaj edhe i kemi bërë edhe amendamentet për Projektligjin për paga. Për rritjen e pagave të profesionistëve shëndetësorë, kërkohet një vendim politik nga ana e Kryeministrit, ashtu siç e ka bërë rritjen e pagave për veti dhe kabinetin qeveritar. Qeveria duhet të gjejë mekanizëm për të rritur pagat e profesionistëve shëndetësorë.

Naser Rugova, tha se nuk do të dëshiroja, që sot të mbahet ky takim, mirëpo, amendamentet të cilat i kemi proceduar në komision, të procedohen dhe të përkrahen nga ana e Komisionit funksional dhe të përkrahen edhe nga Ministria e Financave dhe të miratohet ligji në lexim të dytë, në mënyrë që profesionistët shëndetësorë të kenë paga të dinjitetshme. E kuptoj shqetësimin e punëtorëve shëndetësorë dhe janë kërkesa ligjore. Edhe kaq vite pas pavarësisë, asnjë qeveri deri me tani s'ë ka trajtuar seriozisht sistemin shëndetësor. Kosova ka punëtorë shëndetësorë që e duan punën dhe duan pacientin dhe e vlerësojnë jetën e njeriut. Jam kundër grevës sepse keni rezistuar me vite të tëra, sidomos në këto tri dekadat e fundit, punëtorët e arsimit dhe mjekët që kanë qëndruar këtu, janë heronj të gjallë të sakrificës në luftën për liri dhe pavarësi. Greva e mantelbardhëve është më shumë se sa grevë, më shumë se sa presion edhe sindikal edhe politik sepse jemi në sezonin e dimrit, e dimë numrin rasteve dhe janë klinikat dhe repartet, ku mjekët duhet të jenë në detyrë për të parandaluar vdekjet dhe luftuar për jetën e pacientëve. Ne si komision i kemi shqyrtuar dhe përkrahur kërkesat tuaja, andaj ju lutem edhe njëherë që të provohet të bisedohet me Kryeministrin, me ministrin e financave dhe të shëndetësisë dhe të gjendet zgjidhje, të kemi rritje të pagave të profesionistëve shëndetësorë dhe të kemi mirëqenie shëndetësore të qytetarëve.

Blerim Sylja, theksoj se nuk është në rregull që brenda një viti, vetëm njëherë Kryeministri dhe Kryeparlamentari na kanë takuar si sindikatë, pavarësisht se në vazhdimësi kemi parashtruar kërkesa për takim për të paraqitur shqetësimet e mjekëve. Tani, në situatën në të cilën jemi, duhet të ulemi dhe t'i diskutojmë seriozisht problemet në shëndetësi, sepse problemet janë reale dhe nëse nuk marrim masa, shëndetësia do të ketë probleme serioze.

Kole Krasniqi, tha se kërkesat tona nuk janë politike, por janë kërkesa sociale, të dinjitetshme dhe minimale. Të gjithë po e shohim situatën, por mjekët po kërkojnë dinjitet dhe është e mjerueshme që pacientin të lihet pa shërbim, duke hyrë në grevë.

Drita Millaku, tha se e ndajmë shqetësimin me ju dhe e kemi mbështetjen e Lëvizjes Vetëvendosje. Kërkesat tuaja janë legjitime, por barra kryesore mbetet te Qeveria, e cila nuk po e sjell për miratim Ligjin për Paga. Greva i prek drejtpërdrejt pacientët të cilët janë të pafajshëm. Gjatë leximit të parë të Projektligjit për buxhetin e vitit 2019, u pa se aty nuk është përfshi buxhet për fillimin e sigurimeve shëndetësore dhe buxhet për kategorizimin e pagave. Qeveria është duke marrë vendime politike dhe elektorale dhe nuk është duke gjetur zgjidhje. E jona mbetet t'ju mbështesim edhe tani edhe në të ardhmen, por e përgjithshmeja është se të gjithë duhet të mendojmë për qytetarët.

Selman Selmani, tha se ne e kemi konsumuar dialogun social me Qeverinë dhe kemi ardhur në stadin që për interesat e shërbyesve shëndetësorë të luftojmë. Është momenti i fundit që të reflektojë edhe Qeveria edhe deputetët. Tash një vit kemi investuar shumë në Ligjin për Pagat dhe e kemi diskutuar me të gjithë të involvuarit në këtë proces, por, pasi ligji nuk po kalon, grevat janë të pashmangshme.

Time Kadrijaj, tha se më vjen mirë që jeni këtu dhe po diskutojmë për problemet në shëndetësi të cilat janë të akumuluar tash sa vite dhe se shëndetësia nuk ka qenë prioritet prej pasluftës e deri me sot. Menjëherë pasi është proceduar Projektligji për pagat, e kemi pasur një tryezë të përbashkët dhe kemi menduar që zhgënjimit të mantelbardhëve do ti vije fundi. Projektligji për pagat është në procedurë administrative në komisionin parlamentar përkatës. Ne i kemi bërë si komision amendamentet që i kemi vlerësuar si të nevojshme dhe presim që ligji të kalojë sa më parë. Ju bëj thirrje edhe partive opozitare, që pasi po i përkrahin kërkesat tuaja kur të vije Projektligji për pagat në parlament, ta votojnë sepse nuk po marrin pjesë fare në seancë. Është e pamjaftueshme që t'ju përkrahin vetëm në mënyrë deklarative, nëse nuk ju përkrahin edhe me votë në seancë plenare. Në ligjin e buxhetit është shtuar buxheti për shëndetësi dhe po tregohet se shëndetësia po përkrahet nga kjo Qeveri, qoftë me infrastrukturë, barna apo pajisje mjekësore.

Enver Hoti, theksoi se i përshëndet përpjekjet e FSHSK-së për të avancuar sektorin e shëndetësisë. Më pëlqeu që kërkesa juaj ishte për kategorizim e jo për rritje të pagave, dhe ky kategorizim do ta rregullonte këtë sektor. Ligji për pagat dhe Ligji për Qeverinë janë vonuar shumë tani dhjet vite dhe kjo ka shkaktuar këtë probleme. Kjo ka mundur të rregullohet edhe më herët. Qeveria tani e ka sjellë një Projektligj për pagat dhe të gjitha kërkesat tuaja që janë adresuar kanë gjetur përkrahje nga Komisioni për Shëndetësi dhe janë përfshirë në amendamente. Tani mbetet vetëm t'i përkrahim edhe me votë në seancë, në leximin e dytë të Projektligjit.

Më vjen keq që disa deputetë që nuk kanë marrë pjesë as në leximin e parë të Projektligjit e as në votim, tani ju japin përkrahje populiste. Përkrahja duhet të jepet në seancë me votë. E dimë përgjegjësinë që e kemi, nuk i përkrahim neglizhencat dhe kërkojmë që Qeveria të jetë komunikuese dhe të jetë e gatshme të marrë përgjegjësi dhe të ofrojë zgjidhje të pranueshme. Ligji për pagat dhe shumë ligje të tjera nuk janë pasojë e kësaj qeverie, është dashur të bëhen më herët.

Haxhi Avdyli, tha se presim që Ligji për pagat të vije për lexim të dytë në Kuvend dhe ne do ta votojmë për hir të 200 mijë të punësuarve që preken nga ky ligj. Do ta votojmë këtë ligj ashtu si i kemi votuar shumë marrëveshje ndërkombëtare, që kanë qenë me interes për qytetarët, mirëpo, nëse ky ligj nuk i ka projeksionet buxhetore të reflektuara në buxhetin e vitit 2019, atëherë nuk ka vlerë.

Drita Millaku, tha se është e vërtetë se nuk e kemi votuar Ligjin për Pagat sepse e kemi parë se ligji nuk i ka përfshirë të gjitha kategoritë, prandaj, arsyet tona kanë qenë shumë bindëse.

Time Kadrijaj, tha se e kemi obligim ndaj qytetarëve t'i votoni ligjet, në lexim të parë, Projektligjin për pagat nuk e kemi votuar, tani nëse kemi reflektuar dhe do ta votoni e përshëndes këtë veprim të partive opozitare.

Bekim Haxhiu, pasi e përshëndeti Sindikatën e Shëndetësisë, tha se dhe gjatë tri mandateve të mia si deputet, në vazhdimësi i kam ngritur çështjet dhe mangësitë që kanë qenë në shëndetësi. Edhe pse kam qenë deputet i pozitës, kritikën e mia nuk kanë munguar, duke e ditur se ka defekte

në sektorin e shëndetësisë. Punëtorët shëndetësorë kanë qenë mjaft kreativ dhe me pagat që kanë punuar asnjëherë nuk kanë sjellë probleme dhe gjithmonë kanë qenë në shërbim të pacientëve. Përveç pagave edhe kushtet në të cilat punëtorët shëndetësorë punojnë, lënë për të dëshiruar. Punëtorëve shëndetësor nuk iu ofrohet mbrojtje dhe shpesh janë sulmuar edhe fizikisht gjatë punës së tyre, por më shqetësuese është fakti që tre mjek të radiologjisë janë diagnostifikuar me kancer dhe kjo e rritë nevojën që të bëhet matja e rrezatimit të aparaturave në radiologji.

Te çështja e pagave, kemi shprehur një unitet dhe i kemi përkrahur kërkesat tuaja. Duhet që kategorizimi i pagave të përfshijë përgatitjen profesionale, gradën shkencore dhe titullin akademik. Kam propozuar një amendament në Projektligjin për pagat, i cili rregullon kategorizimin e pagave në gjithë sektorin e shëndetësisë dhe për këtë kam marrë përkrahje edhe nga anëtarët e Komisionit, të cilët i falënderoj. Mendoj që Komisioni për Shëndetësi, Komisioni për Administratë Publike, FSHSK-ja dhe Ministria e Shëndetësisë, të mbajnë një takim të përbashkët dhe të dakordohemi për Ligjin për Pagat për sektorin e shëndetësisë. Punëtorët shëndetësorë duhet të kenë paga të dinjitetshme dhe duhet ta ruajmë kuadrin shëndetësor që të qëndrojë në Kosovë.

Flora Brovina, tha se jemi të interesuar shumë për standardin e punëtorëve shëndetësorë dhe jemi të interesuar që ky personel të mos e lëshojë Kosovën. Ky standard i ultë i punëtorëve shëndetësorë ka ardhur si pasojë e mosmiratimit të disa ligjeve, të cilat do të kishin ndikuar në ngritjen e standardit të punëtorëve shëndetësorë. Në Projektligjin për paga kemi parashtruar disa amendamentet dhe do ti votojmë, por nuk do të jenë të mjaftueshme ti plotësojnë kërkesat e sindikatës dhe punëtorëve shëndetësorë, por, përkrahja jonë do të vazhdojë në mënyrë që të krijojmë kushte për qëndrimin e punëtorëve shëndetësorë në Kosovë.

Blerim Sylja, tha se është shumë e vërtetë që kemi pasur përkrahjen tuaj, por rezultate nuk ka. Ne jemi në çdo kohë për bisedime dhe të gjejmë zgjidhje. Ne nuk kemi dëshirë të hymë në grevë, por grevat janë të pashmangshme. Të bëjmë diçka që ti mbajmë këta punëtorë shëndetësorë dhe të vazhdojnë punën, por ata janë lodhur dhe nuk mund të vazhdojnë më kështu.

Besa Baftiu, kryetare, tha se besojmë që ende ka hapësirë për bisedime dhe bashkëpunim me Qeverinë, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje dhe mos vijë deri te grevat radikale, dhe në këtë rast të pësojnë pacientët.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Besa BAFTIU